



**VENDIM**

**Nr. 153, Datë 30.09.2016**

**PËR  
FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR SHQYRTIMIN DHE MIRATIMIN  
E RREGULLAVE TË ANKANDIT TË ZYRËS SË KOORDINUAR TË  
ANKANDEVE PËR EVROPËN JUGLINDORE (SEE CAO), VERSIONI  
1.4**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 65 pika 1 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të nenit 26 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE nr. 96 datë 17.06.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 30.09.2016, mbasi shqyrtoi draftin e përgatitur dhe të rënë dakord nga (SEE CAO) dhe TSO-të aksionarë të saj, të Rregullave të Ankandit të Zyrës së Koordinuar të Ankandëve për Europën Juglindore (SEE CAO) dhe relacionin përkatës, për fillimin e procedurave për shqyrtimin dhe miratimin e Rregullave të Ankandit të Zyrës së Koordinuar të Ankandëve për Europën Juglindore (SEE CAO) Versioni 1.4.

**Konstatohet se:**

- Sekretariati i Komunitetit të Energjisë (Vjenë, Austri) me shkresën e datës 13.09.2016 dhe mbledhja 11-të e ECEB-së mbajtur më datë 09.07.2009, rekomandojnë që rregullatorët kombëtarë ta miratojnë këtë rregullore.
- OST sh.a. me shkresën nr. 4855 Prot, datë 25.08.2016 ka përcjellë për miratim në ERE draftin e “Rregullave të Ankandit të Zyrës së Koordinuar të Ankandëve për Europën Juglindore (SEE CAO) Versioni 1.4.
- Rregullorja është e hartuar në përputhje me kërkesat e rregullores (KE) 714/2009 të Parlamentit Evropian.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

**Vendos:**

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin dhe miratimin e rregullave të ankandit të zyrës së koordinuar të ankandëve për Evropën Juglindore SEE CAO (bashkëlidhur draft “Rregullat e ankandit, versionin 1.4”).

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë personat e interesuar për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.  
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE**  
**Petrit AHMETI**